



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 795/1 prot.

Datë 31 / 05 / 2018

V E N D I M

Nr. 131 , Datë 31 / 05 / 2018

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën me nr.25 Regj., datë 14.02.2018, e znj.P. H, kundër Bashkisë së Tiranës, me pretendimin për diskriminim për shkak të “*gjendjes ekonomike*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues shprehet se jeton e vetme dhe është kryefamiljare pasi bashkëshorti i ka vdekur. Znj.H shprehet se të ardhurat e vetme janë pensioni që merr në shumën prej 7.000 lekësh. Ajo jeton në një banesë me qira dhe të ardhurat e saj nuk i mjaftojnë për të paguar qiranë, dritat, ujin dhe për t’u ushqyer. Zonja shprehet se ka aplikuar për të përfituar nga skema e ndihmës sociale, por është refuzuar me arsyen se nuk plotëson kriteret. (Zonja shprehet se ndihmën sociale e ka përfituar vetëm për 2 muaj dhe më pas i është ndërprerë).

Znj.H shprehet se ka aplikuar gjithashtu pranë Bashkisë së Tiranës për të përfituar bonus qiraje (së fundmi me datë 22.01.2018) dhe akoma nuk i është kthyer përgjigje. Ajo thekson se është trajtuar me bonus qiraje vetëm për 3 (tre) muaj në shumën prej 7.000 lekësh dhe më pas i është ndërprerë.

Subjekti ankues citon se ndjehet e diskriminuar nga ana e Bashkisë Tiranë, për shkak të gjendjes së saj ekonomike.

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën: KMD.

Znj.H kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit, t'i mundësohet lidhja e ndihmës ekonomike dhe subvencionimi i qirasë së banesës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së², në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”*.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

- 1. Me shkresën me nr.254/1 prot., datë 22.02.2018 i është kërkuar informacion Bashkisë Tiranë, lidhur me pretendimin e znj.H³.**

Me shkresën me nr.7981/1 prot., datë 09.03.2018 Bashkia Tiranë informon Komisionerin se, nga komunikimi i tyre me Njësinë administrative nr.1 rezulton se, subjekti ankues ka aplikuar dhe

² Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

³ Argumentimin Tuaj, lidhur me pretendimet e subjektit ankues.

Informacion nëse znj.H ka aplikuar për përfitim të ndihmës sociale për vitin 2018.

Informacion nëse zonja ka përfitur nga skema e përfitimit të ndihmës sociale. Nëse po, një kopje të procedurës së ndjekur.

Nëse ankuesja nuk ka përfitur, shpjegime se përse nuk ka fituar, si dhe një kopje të dokumentacionit provues.

Informacion nëse znj.H ka aplikuar për përfshirjen në programin e strehimit “Bonus qiraje” për vitin 2018.

Nëse po, një kopje të procedurës së ndjekur prej jush, si dhe përgjigjen që i është kthyer ankuses, lidhur me arsyen e mospërfitimit të këtij bonusi.

Informacion nëse znj.H ka përfitur më përpara nga programi i strehimit “Bonus qiraje”. Nëse po, arsyet se përse ka përfitur, cilat kritere ka përmbushur në momentin e përfitimit, që tani nuk i përmbush.

Çdo informacion tjetër që ju do e gjykoni të arsyeshëm se do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.

përfiturar ndihmën ekonomike nga data 01.10.2015 deri në datën 30.06.2016, më pas i është ndërprerë pasi nuk ka bërë deklarinimin 3 mujor, duke parashtruar se: “ *Kreu II, pika 3 e VKM –së “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”, parashikon se, Administratori shoqëror, në prani të kryetarit të familjes/anëtarit madhor, së bashku me bashkëshorten, kur ka një të tillë, hedh në Regjistrin Kombëtar deklaratën, sipas shtojcës 3, që është pjesë përbërëse e vendimit të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe që plotësohet çdo 3 muaj”*. Por pavarësisht kësaj, Bashkia Tiranë sqaron se, znj.H ka riaplikuar për të përfiturar ndihmën ekonomike në datën 10.01.2018 dhe nuk ka dalë fituese pasi nuk ka marrë pikët e mjaftueshme. Pika 7 e VKM-së sipërcituar parashikon se: “*Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, pas ardhjes së vendimit për propozim nga këshilli bashkiak, verifikon të dhënat e hedhura në Regjistrin Elektronik Kombëtar, konfirmon saktësinë e tyre pranë autoriteteve shtetërore përgjegjëse dhe në bazë të aplikimit të formulës së pikëzuar për familjet në nevojë, gjeneron vendimin për përfitimin e ndihmës ekonomike, përkatësisht:*

- a) *Për familjet/individët përfitues të ndihmës ekonomike dhe masën e përfitimit të tyre;*
- b) *Për familjet jopërfitues me arsyen përkatëse të refuzimit”.*

Sa më sipër, citohet në përgjigje, detyra e njësisë vendore dhe Bashkisë Tiranë në këtë rast, përfundon me hedhjen e të dhënave në Regjistrin Elektronik Kombëtar dhe propozimin në Këshillin Bashkiak. Për të provuar kryerjen e detyrës nga ana e punonësit të njësisë administrative nr.1, bashkëngjitur është dërguar kopja e aplikimit për ndihmën ekonomike dhe formularit të vlerësimit për intervistuesen, znj.H në këtë rast.

2. Në vijim të procedurës për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, me datë 10.04.2018⁴, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, realizoi një inspektim pranë ambjenteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale (DPSHS)/Bashkia Tiranë.

Referuar procesverbalit të datës 10.04.2018, mbajtur nga inspektorët e KMD-së, përfaqësuesit e këtij institucioni shprehën se: “*...znj.H ka qenë përfituese e bonusit të strehimit, referuar VKB (Vendimit të Këshillit Bashkiak) nr.27, datë 23.05.2016, në vlerën 6990 lekë/muaj. Zonja ka përfiturar për një periudhë 3 mujore për shkak se ka rezultuar me mangësi dokumentacioni. (Nuk ka paraqitur Kontratën e qirasë, sikurse përcaktohet në legjislacionin përkatës). Së fundmi, ka aplikuar rishtaz në muajin Mars 2018 dhe meqenëse plotësonte kriteret dhe dokumentacionin e përcaktuar nga ligji, rezultoi përfituese e këtij bonusi”*. B/ngjit procesverbalit nga ana e DPSHS/Bashkia Tiranë u depozitua si provë shkresore dokumentacioni provues lidhur me praktikën e mbajtur.

⁴ Në zbatim të Urdhërit nr.65, datë 29.03.2018, të Komisionerit.

3. Me shkresën me nr.254/5 prot., datë 05.04.2018 iu kërkua informacion Shërbimit Social Shtetëror (SHSSH) lidhur me pretendimin e znj.H për mospërfitimin e ndihmës ekonomike⁵.

Me shkresën me nr.654/4 prot., datë 30.04.2018 Shërbimi Social Shtetëror informon Komisionerin se: *“Lidhur me mospërfitimin e ndihmës ekonomike nga ana e znj.H, nga verifikimi në sistemin elektronik të pikëzimit, kjo familje ka qenë përfituese e ndihmës ekonomike me tre anëtarë për periudhën 01.06.2014 deri në 01.04.2015 në shumën 5580 lekë në muaj. Më pas ka bërë ndryshim në trungun familjar ku ka kaluar familje me dy anëtarë dhe ka përfituar shumën prej 3060 lekësh për periudhën 01.05.2015 deri 30.09.2015. Pas kësaj periudhe, ka riaplikuar si familje me një anëtar dhe ka qenë përfituese e shumës 1800 lekë për periudhën 01.10.2015 deri 30.06.2016, dhe është refuzuar nga sistemi për mosparaqitje për të bërë deklaratën 3-mujore. Pas kësaj ka riaplikuar në muajin Janar 2018 dhe është refuzuar nga sistemi pasi nuk ka marrë “pikët e mjaftueshme”. Drejtoria Rajonale e SHSSH, pas ardhjes së vendimit për propozim të këshillit bashkiak, verifikon të dhënat e hedhura në Regjistrin Elektronik Kombëtar, konfirmon saktësinë e tyre pranë autoriteteve shtetërore përgjegjëse dhe në bazë të aplikimit të formulës së pikëzuar për familjet në nevojë, gjeneron vendimin për përfitimin e ndihmës ekonomike. Znj.H është përfituese e pensionit familjar në masën 7635 lekë në muaj. Jeton në lagjen “Ali Demi” sipas kontratës që ka vënë në dispozicion pranë njësisë administrative nr.1, specialitet e Drejtorisë Rajonale shkuan për të kryer një vlerësim social, ekonomik në familje, por me adresën e dhënë nga zonja si dhe duke marrë informacion në komunitet, nuk u arrit të identifikohet banesa”. Për sa citohet është vënë në dispozicion të Komisionerit një kopje e procedurës së ndjekur prej tyre.*

4. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr.10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes së znj.H, Komisioneri me datë 14.05.2018 realizoi një seancë dëgjimore mes palëve⁶.

Subjekti ankues nuk ishte i pranishëm, ndërsa Drejtoria Rajonale e SHSSH u përfaqësua nga znj.T. S dhe znj.V. K, me detyrë specialiste pranë DRSHSSH-së⁷. Përfaqësueset e DRSHSSH-së u qëndruan të njëjtave parashtrime si në shkresën me nr. 654/4 prot., datë 30.04.2018 të SHSSH-së duke shtuar se: *“Në momentin që znj.H është refuzuar nga sistemi i pikëzimit dhe nuk ka qenë*

⁵ Argumentimin Tuaj, lidhur me pretendimet e subjektit ankues.

Një kopje të praktikës së mbajtur, lidhur me aplikimin e znj.Prandvera Hasula. (për vitin 2018)

Nëse ankuesja nuk ka përfituar, shpjegime se përse nuk ka fituar, si dhe një kopje të dokumentacionit provues.

Një kopje të praktikës së mbajtur me Bashkinë Tiranë, lidhur me vendimin e mospërfitimit të ndihmës ekonomike, për znj.Prandvera Hasula.

Informacion nëse subjekti ankues e ka ankimuar pranë jush, vendimin e mospërfitimit të ndihmës ekonomike.

Nëse po, një kopje të ankimit dhe të përgjigjes së dhënë prej jush.

⁶Në zbatim të Njoftimit me nr.608 prot., datë 04.05.2018, të Komisionerit.

⁷ Referuar shkresës me nr.566 prot., datë 14.05.2018 “Autorizim përfaqësimi” në seancën dëgjimore pranë KMD-së.

dakort duhet të ishte ankuar pranë Institucionit tonë, sikurse e parashikon ligji. Megjithatë sapo jemi njohur me këtë fakt, kemi takuar administratoren e Njësisë nr.1, së cilës i kemi kërkuar adresën e ankueses për të shkuar dhe verifikuar në banesë gjendjen social-ekonomike të zonjës. Nga ana tjetër ajo ka mundësinë të deklarojë edhe dhuratat apo personat që e ndihmojnë. Në banesën e zonjës, në momentin që kemi vajtur për bisedim dhe verifikim në vend, është prezantuar vajza e znj.H, e cila, sikurse rezulton nga procesverbali i mbajtur, nuk ka lejuar që ne të hyjmë brenda banesës dhe të verifikojmë kushtet e saj. Theksojmë se ky veprim shton dhe dyshimin se “ndarja” e saj nga trangu familjar (me znj.H) në Zyrën e Gjendjes Civile, me anë të certifikatës ku figuron kryefamiljare e vetme, është fiktive dhe jo reale dhe se ato mund të ndajnë të njëjtën banesë dhe jetojnë së bashku. Znj.H përballon një kontratë qiraje prej 20.000 mijë lekësh dhe njëherësh nuk deklaron asnjë të ardhur. Në raste të tilla ne bëjmë një verifikim besueshmërie, pasi duhet të ketë përputhje të informacioneve të hedhura në sistem dhe atyre reale, faktike. Znj.H vazhdimisht ka ndryshuar variantet e deklaratave të saj. Sistemi lidhet automatikisht me Zyrën e Gjendjes Civile për verifikimin e të dhënave të deklaruara nga kërkuesi. Ka mospërputhje mes deklarimeve të ankueses dhe fakteve”.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

III. Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës dhe bazuar në dokumentacionin e administruar, Komisioneri vëren se:

A. Lidhur me pretendimin e ankueses se është trajtuar në mënyrë të disfavorshme dhe diskriminuese nga ana e Bashkisë Tiranë.

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi⁸”, neni 1 sipërcituar dhe neni 3/1, parashikojnë se: “*Diskriminim*” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.

Kodi i Procedurës Administrative, i ndryshuar, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast Bashkisë Tiranë. Pra, në këtë rast Bashkia Tiranë duhet të provonte se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe më pak të favorshme, për shkak të gjendjes ekonomike.

Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: “*Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë*

⁸ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“ Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin komisionerin në përmbushjen e detyrave të tij, veçanërisht duke i dhënë informacionin që i nevojitet atij”.*

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

- **Lidhur me pretendimin e trajtimit në mënyrë të pafavorshme dhe diskriminuese sa i takon çështjes së subvencionimit të qirasë, konstatojmë se:**

Nga verifikimi dhe këqyrja e dokumentacionit rezulton se znj.H ka qenë përfituese e bonusit të strehimit⁹ në vlerën prej 6990 lekësh në muaj. Ka përfituar vetëm për 3 muaj për shkak se ka rezultuar me mungesë dokumentacioni, pasi nuk kishte depozituar kontratën e qirasë, sikurse përcaktohet në legjislacionin përkatës.

Referuar ligjit të strehimit nr.9232, datë 13.05.2004, i ndryshuar, neni 16, pika 1 e tij ka përcaktuar se: *“Familja që përfiton bonus strehimi, duhet të lidhë kontratë qiraje brenda tre muajve nga data e miratimit të bonusit”.* Gjë që nuk ka ndodhur nga ana e subjektit ankues.

Me shkresën me nr.P-4834, datë 23.02.2018 ankuesja ka aplikuar pranë Bashkisë Tiranë për të përfituar nga trajtimi si e pastrehë.

Me shkresën me nr.P-4834/1, datë 20.03.2018 Bashkia Tiranë ka informuar ankuesen se, pas kalimit në fazën e dytë të aplikimit, pas dorëzimit të dokumentacionit nga ana e saj, do të jetë Komisioni i Strehimit që do të bëjë vlerësimin e dosjes dhe më pas Këshilli Bashkiak, si organ vendimmarrës, do të vendosë nëse ajo do të rezultojë përfituese e bonusit të qirasë.

⁹ Referuar VKB-së nr.27, datë 23.05.2016

Në vijim të komunikimit shkresor me Bashkinë Tiranë, Komisioneri është informuar se pas aplikimit të muajit Mars 2018, meqenëse ankuesja plotësoi kriteret dhe dokumentacionin e përcaktuar nga ligji, rezultoi përfituese e këtij bonusi.

Pra, në përfundim të sa mësipër, Komisioneri konkludon se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të pafavorshme nga ana e Bashkisë Tiranë, sa i takon pretendimit të saj lidhur me problematikën e strehimit, përftimit të bonusit të qirasë, pasi ajo në rastin e skualifikimit të saj kishte patur mangësi në dokumentacion; ndërsa në rastin e dytë që ka paraqitur gjithë dokumentacionin e kërkuar ka rezultuar përfituese.

- Lidhur me pretendimin e trajtimit në mënyrë të pafavorshme dhe diskriminuese sa i takon çështjes së përfitimit të ndihmës ekonomike, konstatojmë se:

Nga verifikimi në sistemin elektronik të pikëzimit, znj.H ka qenë përfituese e ndihmës ekonomike me tre anëtarë për periudhën 01.06.2014 deri në 01.04.2015 në shumën 5580 lekë në muaj. Më pas ka bërë ndryshim në trungun familjar ku ka kaluar familje me dy anëtarë dhe ka përfituar shumën prej 3060 lekësh për periudhën 01.05.2015 deri 30.09.2015. Pas kësaj periudhe, ka riaplikuar si familje me një anëtar dhe ka qenë përfituese e shumës 1800 lekë për periudhën 01.10.2015 deri 30.06.2016, dhe është refuzuar nga sistemi për mosparaqitje për të bërë deklaratën 3-mujore.

“ Kreu II, pika 3 e VKM –së “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”, parashikon se, Administratori shoqëror, në prani të kryetarit të familjes/anëtarit madhor, së bashku me bashkëshorten, kur ka një të tillë, hedh në Regjistrin Kombëtar deklaratën, sipas shtojcës 3, që është pjesë përbërëse e vendimit të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe që plotësohet çdo 3 muaj”.

Pas kësaj ka riaplikuar në muajin Janar 2018 dhe është refuzuar nga sistemi pasi nuk ka marrë “pikët e mjaftueshme”.

Legjislacioni për përfitimin e ndihmës ekonomike ka parashikuar se familjet pa të ardhura dhe me të ardhura të pamjaftueshme, si dhe kategori të tjera të përcatuara në ligj, mund të aplikojnë për përfitimin e ndihmës ekonomike pranë njësisë vendore ku kanë vendbanimin.

Për përfitimin e kësaj ndihme, kryefamiljari nga data 01-10 e çdo muaji duhet të paraqitet pranë administratorit shoqëror të Seksionit të Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Shoqërore në Bashki/Njësi Administrative për të aplikuar për ndihmë ekonomike si familje në nevojë, duke paraqitur dokumentacionin e përcaktuar në aktet nënligjore.

Administratori më pas, plotëson on-line në sistem aplikimin për ndihmë ekonomike, ku përfshihet gjithë informacioni për: demografinë e familjes, arsimin dhe punësimin, llojin e banesës, pasuritë/asetet shtëpiake, të ardhurat nga programet e mbrojtjes sociale. Eshtë me shumë rëndësi që informacioni të jetë i saktë, pasi në rast të kundërt penalizohen familjet për deklaram të rremë.

Pasi të jetë verifikuar automatikisht saktësia dhe vërtetësia e informacionit nga ana e sistemit elektronik, merret vendimi për këto familje.

Vendimi për ndihmën ekonomike merret brenda muajit nga DRSHSSH-ja. Familjet të cilat nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme kanë të drejtën e riaplikimit në muajt pasardhës dhe gjithashtu kanë të drejtën e ankimimit ndaj vendimit të marrë.

Komisioneri thekson se pas verifikimit të formularit të aplikimit të ankueses rezulton se tek deklarimi i të ardhurave, ajo ka deklaruar vlerën 0 (zero) lekë, ndërkohë që deklaron se paguan një qira mujore prej 20.000 (njëzet mijë) lekësh. Ky deklarim përbën shkak për refuzimin e saj nga sistemi për deklarim të rremë, sikurse citohet dhe në shkresën e SHSSH, për mospërputhje të deklarimit nga ana e znj.H dhe të dhënave në sistem.

Theksojmë gjithashtu, se znj.H nuk e ka ankimuar vendimin sipas parashikimeve ligjore sipërcituar.

Nga ana tjetër, pas informimit nga ana e Komisionerit të ankesës së znj.H, DRSHSSH është vënë në lëvizje për verifikimin e saj dhe referuar procesverbalit të mbajtur (depozituar në dosjen e subjektit ankues pranë KMD-së) kanë vajtur në banesë për bisedime dhe verifikimet përkatëse, por kanë hasur në pengesë nga një person që është ndodhur në banesën e znj.H (ankuesja nuk ndodhej në banesë) dhe që është prezantuar si e bija.

Në këto kushte, Komisioneri i rekomandon subjektit ankues të tregohet i kujdesshëm dhe i saktë në plotësimin e formularit për ndihmën ekonomike; si dhe në rast të mosdakortësisë me vendimin e DRSHSSH-së të bëjë ankimim sipas parashikimeve ligjore sipërcituar.

Komisioneri konstaton se qëndrimi i DRSHSSH bazohet në verifikimin e të dhënave dhe deklarimeve të subjektit ankues, dhe se përgjegjësinë për vërtetësinë e tyre e bart vetë subjekti.

Neni 7, pika 1, e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

Komisioneri, vlerëson se për sa më sipër, nuk konstatohet se ka shkelje të nenit 7/1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, me veprim ose mosveprim nga ana e subjekteve ndaj të cilëve znj.H është ankuar, që të krijojë baza për mohimin e barazisë ose që ekspozon atë ndaj një trajtimi të padrejtë dhe diskriminues në raport me të drejtat e tij ligjore.

Në përfundim, Komisioneri gjykon se ndaj subjektit ankues, znj.P. H nuk ka patur trajtim apo qëndrim diskriminues, nga ana e Bashkisë Tiranë kundër së cilës ka paraqitur ankesën pranë Zyrës së KMD-së.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 32, pika 1, germa a) dhe, nenin 33, pika 10 të Ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të gjendjes ekonomike të znj.P. H, nga ana e Bashkisë Tiranë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

(shkaku: gjendja ekonomike)
(fusha: të mira dhe shërbime)